



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"  
VLORE  
ZYRA E PROTOKOLL - ARKIVËS  
NR. 388 PROT.  
DATA 24.01.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE  
DEKANI

Nr. 84/..... Prot.

Vlorë, më 23.01.2025

Lënda: Përcjellje e thirrjes për hapjen e aplikimeve për programin e studimit të Doktoraturës në "Studime gjuhësore, letrare dhe kulturore", viti akademik 2024-2025.

**PROF. DR. AURELA SALIAJ,**

**REKTORE E UV-së**

**KËTU**

Në mbështetje të nenit 42, të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe pikës 7 të Nenit 7 të Rregullores së Brendëshme të UV-së, bashkëlidhur po Ju përcjellim tekstin e thirrjes për hqapjen e aplikimeve për programin e studimit Doktoratë në "Studime gjuhësore, letrare dhe kulturore", viti akademik 2024-2025, të departamentit të Gjuhëve të Huaja dhe departamentit të Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë pranë Fakultetit të Shkencave Humane, miratuar në mbledhjet e departamenteve, datë 23. 01. 2025, respektivisht dhe në mbledhjen e dekanatit, datë 23. 01. 2025, bauer në nenin 23/4 në ligjin nr. 80/2015

Bashkëlidhur dokumentacioni i përcjellë nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja dhe Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

DEKAN  
Prof. Dr. Roland Zisi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE  
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA  
DEPARTAMENTI I GJUHË-LETËRSISË

Nr. 84 prot.

Vlorë, më 23.01.2025

**Lënda:** Përcjellje e vendimeve për "Thirrjen për hapjen e aplikimeve për programin e studimit të Doktoraturës në "Studime gjuhësore, letrare dhe kulturore", për vitin akademik 2024-2025.

DEKANIT TË FAKULTETIT TË SHKENCAVE HUMANE  
PROF. DR. ROLAND ZISI

KËTU

I nderuar Z. Dekan,

Mbështetur në pikën *a* te nenit *6*, nenit *10* dhe *11*, pikave *a* dhe *b* te nenit *15* të Rregullores për "Organizimin e Ciklit të Tretë të Studimeve, "Doktoraturë", në "Studime Gjuhësore, Letrare dhe Kulturore", miratuar në Vendimin SA, Nr.43, datë 15.11.2021, si dhe në Akt-Marrëveshjen e posaçme të bashkëpunimit dhe përgjegjësive mes dy departamenteve, Departamenti i Gjuhëve të Huaja në mbledhjen e tij datë 23.01.2025 dhe Departamenti i Gjuhë Letërsisë në mbledhjen e tij të datës 23.01.2025,

VENDOSËN

1. Të miratojnë "Thirrjen për hapjen e aplikimeve për programin e studimit të Doktoraturës në "Studime gjuhësore, letrare dhe kulturore", për vitin akademik 2024-2025". (Materiali bashkëlidhur).
2. Të miratojnë kërkesën për publikimin e kësaj Thirrjeje në faqen zyrtare elektronike të UV-së, konform procedurës ligjore të parashikuar për këtë rast (Materiali bashkëlidhur).
3. Kopje të Thirrjes për Kërkesë për publikim ruhen në arkivin e departamentit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTUESE E DEPARTAMENTIT  
PROF. AS. KOZETA HYSO

DREJTUESE E DEPARTAMENTIT  
PROF. AS. MONIKA HASANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE**  
**DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA**  
**DEPARTAMENTI I GJUHË - LETËRSISË**

**THIRRJE PËR APLIKIM PËR REGJISTRIM NË PROGRAMIN E DOKTORATËS**  
**PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024, PRANË FAKULTETIT TË SHKENCAVE**  
**HUMANE, UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORË**

Programi i studimit "Doktoratë" në "Studime gjuhësore, letrare dhe kulturore" ofrohet nga grupimi i njësisë: Departamenti i Gjuhëve të Huaja në bashkëpunim me Departamentin e Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë, Fakulteti i Shkencave Humane, Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë.

**AFATI I APLIKIMIT: 27 janar -28 shkurt 2025**

Hapja e programit bazohet në legjislacionin si vijon:

**Ligji nr. 80/2015** "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë";

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018, "Për Elementet e Programeve të Studimit të Ofruara Nga Institucionet e Arsimit të Lartë", i ndryshuar.

**VKM nr. 112**, datë 23.02.2018 , "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore 'Doktor' dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë 'Profesor i Asociuar' dhe 'Profesor ', i ndryshuar.

**VKM nr. 777**, datë 26.12.2018, "Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore", i ndryshuar.

**Udhëzimi** i Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.52 , datë 03.12.2015 "Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar.

**Udhëzimi** i Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 16, datë 08.07.2019, "Për paisjen e institucioneve të arsimit të lartë me regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave".

**Udhëzimi** i përbashket i Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe atij të Financave dhe Ekonomisë nr. 20, datë 20.9.2019 "Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor."

**Udhëzimi** i Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë n r. 1 , datë 14.1.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE**  
**DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA**  
**DEPARTAMENTI I GJUHË - LETËRSISË**

*arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisë kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar me Udhëzimin n r. 7, datë 3 1. 3.2021 .*

**Udhëzim** i Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 10, datë 30.3.2020 "*Për përcaktimin e elementeve përbërës, formën e diplomës ose çertifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në Regjistrin Shtetëror të Diplomave dhe Çertifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor*".

**Udhëzim** i Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 29, datë 10.09.2018 "*Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL*".

**Statuti** i Universitetit të Vlorës "Ismail Qemali".

**Vendimin e SA-së** nr. 62, datë 11.02.2020 "*Për kriteret dhe standardet për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve të përdorura për marrjen e gradës shkencore në UV*", i plotësuar me vendimin e SA-së nr. 94, datë 21.10.2020.

**Vendim Senati** Nr. 6, datë 02.02.2022 "*Për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve në të gjitha ciklet për 2023 – 2024*"

**Rregulloren** për organizimin e ciklit të tretë të studimeve (doktoratë) në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.

**Rregulloren** për organizimin e programit të studimit "Doktoratë" në "Studime gjuhësore, letrare, kulturore", miratuar me Vendim Senati datë 16.11.2021.

**Rregulloren** e Etikës dhe Publikimit Shkencor të UV-së,

**Akt-Marrëveshjen** për Grupimin e Njësisë Bazë për bashkërendimin e veprimtarive dhe përgjegjësisë për organizimin dhe realizimin e programit të studimit "Doktoratë" në "Studime gjuhësore, letrare, kulturore" nënshkruar midis dy njësisë, ( DGJH & DGJL) me nr prot. 607 datë 16.11.2021.

**Urdhër** i Ministrisë të Arsimit nr. 96 datë 25.02.2022 "*Për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë "Doktoratë" në "Studime gjuhësore, letrare, kulturore" në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë*".

**Udhëzimi** i Ministrisë të Arsimit nr 10, datë 16.06.2023 "*Për një ndryshim në udhëzimin nr .52 datë 03.12.2015 "Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE**  
**DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA**  
**DEPARTAMENTI I GJUHË - LETËRSISË**

ndërkombëtare për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë në institucionet e arsimit të lartë”, I ndryshuar.

**A. KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI PËR T'U PËRFSHIRË NË PROGRAMIN E DOKTORATËS NË STUDIME GJUHËSORE, LETRARE, KULTURORE NË DEPARTAMENTIN E GJUHËVE TË HUAJA DHE DEPARTAMENTIN E GJUHËS SHQIPE DHE LETËRSISË**

Për t'u pranuar në programin e doktoraturës, kandidati duhet të përmbushë kriteret themelore të pranimit si më poshtë vijon:

- a. Të zotërojë diplomë të ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave”, diplomë të integruar të studimeve të ciklit të dytë ose çdo diplomë tjetër të vlerësuar të barazvlefshme me të, diplomëtë fituar jashtë vendit të njohur dhe të njësuar nga organet kompetente në fushat/nënfushat e mëposhtme të studimit:
  - studime letrare;
  - gjuhësi;
  - mësimdhënie e gjuhës së huaj (angleze, italiane, etj);
  - mësimdhënie e gjuhës shqipe dhe letërsisë;
  - përkthim dhe interpretim;
  - komunikim (ndërkulturor);
  - fusha/nënfusha të tjera filologjike/humane që lidhen me studimin e gjuhës, letërsisë e kulturës/ave.
- b. Të ketë notë mesatare të paktën 8 (tetë) në çdo diplomë që zotëron, të lëshuar nga IAL-të shqiptare apo të huaja.
- c. Në rast të numrit të barabartë të kandidatëve, prioritet u jepet kandidatëve që kanë ndjekur programet e studimit “Master i Shkencave” pranë Departamentit të Gjuhëve të Huaja dhe Departamentit të Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë, Fakulteti i Shkencave Humane, UV.
- d. Nëse numri i kandidatëve është sërish i barabartë, prioritarë do të jenë kandidatët që janë anëtarë të personelit akademik të këtyre njësive.
- e. Të zotërojë një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht dhe italisht), niveli C1, vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin e lartë. Ky kriter është i vlefshëm për kandidatë që kanë fituar një diplomë të një programi studimi që nuk është kryer në një nga këto gjuhë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE**  
**DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA**  
**DEPARTAMENTI I GJUHË - LETËRSISË**

- f. Të dëshmojë pjesëmarrje në aktivitete mësimdhënëse universitare dhe shkencore (konferenca, seminare, kongrese, simpoziume) dhe publikime në fushat/nënfushat e programit të doktoratës.
- g. Të ketë hartuar projekt-propozimin sipas kërkesave në shtojcën bashkëlidhur.

**Si do të për zgjidhen kandidatët ?**

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të vlerësimit të dosjes së aplikimit nga komisioni *ad-hoc*.

**B. KUSH MUND TË APLIKOJË NË PROGRAMIN E DOKTORATËS NË STUDIME GJUHËSORE, LETRARE, KULTURORE NË DEPARTAMENTIN E GJUHËVE TË HUAJA DHE DEPARTAMENTIN E GJUHËS SHQIPE DHE LETËRSISË**

Studimet doktorale kanë përparësi për ata persona që kanë detyrim ligjor kualifikimin e tyre në nivelin e tretë të studimeve, për shkak të punësimit si personel akademik në IAL.

- Personel akademik i punësuar me kohë të plotë në Fakultetin e Shkencave Humane.
- Personel akademik me kohë të pjesshme i punësuar pranë Fakultetit të Shkencave Humane.
- Personel akademik nga fakultete të njëjta nga universitete publike dhe jopublike.
- Punonjës të institucioneve dhe organizatave publike e jopublike që përfshihen në kërkim ose zbatim, aktiviteti i të cilave lidhet me fushat e kërkimit të njëjësive bazë që ofrojnë programin e doktoratës.

**C. DOKUMENTACIONI PËR APLIKIM**

Dorëzimi i dosjes së aplikimit me dokumentacionin e duhur, bëhet pranë zyrës së protokoll-arkivës së Fakultetit të Shkencave Humane. Aplikimet pranohen çdo ditë pune në orarin 08:00-16:00 nga data 27.01.2025-28.02.2025.

**Dosja e aplikantit duhet të përmbajë dokumentacionin e mëposhtëm:**

Për të aplikuar, kandidati dorëzon pranë zyrës së protokoll-arkivit të fakultetit dosjen me dokumentacionin e mëposhtëm:





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE**  
**DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA**  
**DEPARTAMENTI I GJUHË - LETËRSISË**

- a. Kopje të dokumentit identifikues (pasaportë/kartë identiteti)
- b. Fotokopje të noterizuar të diplomave të fituara në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve  
Diplomat e fituara në universitete jashtë vendit duhet të jenë të njësuara. Dokumenti i njësimi i lëshuar nga ministria përkatëse për arsimin duhet të shoqërojë këto diploma;
- c. Listën e notave për secilin program studimi të kryer (cikli i parë dhe cikli i dytë)
- d. Curriculum vitae
- e. Dëshmi të gjuhës së huaj të mbrojtur sipas përcaktimeve në rregullore
- f. Dëshmi dhe vërtetime që lidhen me kualifikime, trajnime të mëtejshme, publikime pjesëmarrje në aktivitete shkencore në fushën/nënfushën e studimit të programit të doktoratës
- g. Dy rekomandime nga personel akademik i kategorisë "Profesor"
- h. Projekt-propozimin për temën e doktoratës, i hartuar sipas kërkesave të përcaktuara në shtojcën bashkëlidhur
- i. Deklaratë personale për përballimin e shpenzimeve të programit të doktoratës, në rast vetëfinancimi;
- j. Deklaratë e udhëheqësit shkencor për angazhim në udhëheqje të kandidatit
- k. Vërtetim pune, nëse ka
- l. Mandat-pagesën për tarifën e aplikimit

Pas marrjes në dorëzim të dokumentacionit, aplikantit i lëshohet vërtetim për marrjen në dorëzim të dosjes.

**E. PROFESORATI**

**DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA**

Nr.	Personeli akademik	Titulli akademik dhe fusha e ekspertizës (prof./prof. as.) gradë shkencore në:	Lloji i angazhimit
1	Armela Panajoti	(Prof. as) doktor i shkencave në letërsi angleze Hulumtime të mëtejshme në teori të letërsisë.	Me kohë të plotë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE**  
**DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA**  
**DEPARTAMENTI I GJUHË - LETËRSISË**

		letërsi angleze, letërsi amerikane, studime kulturore, komunikim ndërkulturor	
2	Bledar Toska	(Prof. as) doktor i shkencave në gjuhësi/gjuhësi teksti  Hulumtime të mëtejshme në gjuhësi teksti, analizë diskursi, përvetësim i gjuhës së huaj	Me kohë të plotë
3	Frosina Londo (Qyrdeti)	(Prof. as) doktor i shkencave në mësimdhënie/didaktikë të gjuhës italiane  Hulumtime të mëtejshme në didaktikë të gjuhës italiane, studime kulturore e letrare	Me kohë të plotë
4	Kozeta Hyso	(Prof. as) doktor i shkencave në leksikologji për mësimdhënie/didaktikë të gjuhës angleze Hulumtime të mëtejshme në metodikë e didaktikë të gjuhës angleze	Me kohë të plotë
5	Meri Gjoleka	(Prof. as) doktor i shkencave në gjuhësi/gjuhësi e krahasuar  Hulumtime të mëtejshme në gjuhësi, gjuhësi të krahasuar	Me kohë të plotë
6	Veneranda Hajrulla	(Prof. as) doktor i shkencave në mësimdhënie/didaktikë të gjuhës angleze  Hulumtime të mëtejshme në metodikë e didaktikë të gjuhës angleze	Me kohë të plotë
7	Zamira Alimemaj	(Prof. as) doktor i shkencave në gjuhësi. Hulumtime të mëtejshme studime të përkthimit sociolinguistikë.	Me kohë të plotë
8	Ilda Kanani	(Prof. as) doktor i shkencave në gjuhësi studime të përkthimit/interpretimit. Hulumtime të mëtejshme në gjuhësi studime të përkthimit/interpretimit.	Me kohë të plotë
9	Evis Çelo	(Prof. as) doktor i shkencave në gjuhësi studime të përkthimit/interpretimit. Hulumtime të mëtejshme në gjuhësi studime të përkthimit/interpretimit.	Me kohë të plotë





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE  
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA  
DEPARTAMENTI I GJUHË - LETËRSISË

DEPARTAMENTI I GJUHË - LETËRSISË

Nr.	Personeli akademik	Titulli akademik dhe fusha e ekspertizës (prof./prof. as.) gradë shkencore në:	Lloji i angazhimit
1	Roland Zisi	(Prof. dr.) doktor i shkencave në letërsi Hulumtime të mëtejshme në teori të letërsisë, letërsi shqipe, letërsi e huaj	Me kohë të plotë
2	Bardhosh Gaçe	(Prof. dr.) doktor i shkencave në letërsi/letërsi shqipe Hulumtime të mëtejshme në letërsi shqipe, etnografi, trashëgimi kulturore	Me kohë të plotë
4	Monika Hasani (Hoshafi)	(Prof. as.) doktor i shkencave në gjuhësi Hulumtime të mëtejshme në gjuhësi, gjuhësi të krahasuar/etnolinguistikë/ metodikë e gjuhës	Me kohë të plotë
5	Artan Xhaferaj	(Prof. as.) doktor i shkencave në gjuhësi. Hulumtime të mëtejshme në gjuhësi, culture gjuhe. Hulumtime të mëtejshme në gjuhësi, fonetike, histori e gjuhes shqipe	Me kohë të plotë
6	Gladiola Elezi (Durmishi)	(Prof. as.) doktor i shkencave në gjuhësi Hulumtime të mëtejshme në gjuhësi, gjuhësi të krahasuar	Me kohë të plotë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE**  
**DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA**  
**DEPARTAMENTI I GJUHË - LETËRSISË**

**F. FUSHAT KRYESORE TË KËRKIMIT**

Programi i studimit "Doktoratë" në "Studime gjuhësore, letrare e kulturore" do të realizohet bazuar në projekte kërkimore-shkencore dhe zhvillimi të koordinuara nga njësia/të bazë, të cilat i përgjigjen qëllimit të programit për të formuar studiues dhe kërkues të rinj për të kryer kërkim dhe hulumtim të mirëfilltë në fushat *gjuhësore, letrare dhe kulturore* duke:

- përdorur qasje teorike dhe metodologji shkencore bashkëkohore për trajtimin e çështjeve,
- integruar teknologjinë e informacionit dhe komunikimit në mbledhjen e të dhënave dhe analizimin e tyre,
- thelluar e specializuar njohuritë në gjuhësi, letërsi, kulturë si thelbësore në kontekstin e sotëm shoqëror të shënjuar nga globalizmi, ndërkombëtarizimi dhe ndërkulturaliteti.
- thelluar dhe të pasuruar njohuritë teorike dhe praktike të doktorantëve në fushat e shkencave që ndërthhen programi .
- ju bërë të njohur dhe rekomanduar doktorantëve mjetet metodike kryesore që do t'u lejojnë atyre të kryejnë kërkime në fushën studimore dhe t'i aftësojë ata me metodat, teknologjitë dhe shprehitë e punës kërkimore-shkencore origjinale;
- inkurajuar doktorantët për analiza të thelluara kritike e të argumentuara në fushat hulumtuese përkatëse;
- nxitur kërkimet dhe studimet përmasë me karakter aplikativ.

Mbi këtë bazë propozohen (nën)fushat për projekt-propozimet e kandidatëve për doktorantët. Në funksion të realizimit të projektit, do të bashkërendohet më pas edhe programi individual i doktorantit, i cili do të ndërthejë veprimtari kërkimore-shkencore dhe krijuese, si bazë për përgatitjen e tezës së doktoratës (disertacionit).

**FUSHAT DHE NËNFUSHAT SIPAS STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË KËRKIMIT**

- **FUSHA - Studime gjuhësore:**

- gjuhësi e krahasuar,





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE**  
**DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA**  
**DEPARTAMENTI I GJUHË - LETËRSISË**

- gjuhësi e zbatuar,
- gjuhësi teksti,
- kulture gjuhe
- sociolinguistikë,
- psikolinguistikë,
- gjuhësi kompjuterike,
- pragmatikë,
- semantikë,
- leksikologji,
- analizë diskursi,
- didaktikë dhe mësimdhënie e gjuhëve (angleze, italiane, shqipe)
- përkthim dhe interpretim,
- gramatikë.
- **FUSHA-Studime letrare:**
  - teori e letërsisë dhe kulturës,
  - letërsi e vendeve/ në gjuhë të ndryshme,
  - letërsi e krahasuar,
  - folklor,
  - kritikë letrare.
- **FUSHA- Studime kulturore:**
  - studime britanike,
  - studime amerikane,
  - studime italiane.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE**  
**DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA**  
**DEPARTAMENTI I GJUHË - LETËRSISË**

- studime shqiptare,
- kulturë dhe qytetërim i vendeve anglofone,
- kulturë dhe qytetërim i vendeve shqipfolëse,
- kulture dhe qytetërim italian.

- **Nënfusha ndërdisiplinare:**

- studime të komunikimit,
- komunikim ndërkulturor/edukim ndërkulturor,
- studime për media,
- studime për filmin,
- edukim gjuhësor.

**G. KONTAKT:** email: [sekretaria.fshh@univlora.edu.al](mailto:sekretaria.fshh@univlora.edu.al)

*Adresa: Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë*

*Lagjja: Hajro Çakërrri*

*Rruga: Sulejman Delvina, Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë , Vlorë , Shqipëri.*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE**  
**DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA**  
**DEPARTAMENTI I GJUHË - LETËRSISË**

**SHTOJCA 1**

**PROJEKT-PROPOZIMI PËR TEMËN E DOKTORATËS**

**1. Të dhëna të përgjithshme**

Emri i studentit  
Programi i studimit  
Udhëheqësi i propozuar.

**2. Përshkrimi i projekt-propozimit**

➤ *Titulli i temës:*

(Këtu jepet një titull i qartë i temës për projektin kërkimor që përmban fjalë kyçe që e identifikojnë dhe përshkruajnë atë.)

➤ *Fusha/nënfusha:*

(Këtu jepet fusha dhe nënfusha, të cilës i përket objekti i hulumtimit shkencor të projektit kërkimor.)

➤ *Abstrakti:*

(Një sintezë prej 250-300 fjalësh e studimit të planifikuar që përfshin këto elemente: qëllimin e studimit, pyetjet dhe hipotezat, metodologjinë e hulumtimit, rezultatet e pritshme, diskutime.)

➤ *Fjalët kyçe:*

(Këtu jepen fjalë kyçe që përfaqësojnë përmbajtjen e studimit dhe lidhen me fushën/nënfushën e studimit.)

➤ *Hyrja:*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE**  
**DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA**  
**DEPARTAMENTI I GJUHË - LETËRSISË**

(Një përmbledhje e qartë për objektin e studimit, pse është i rëndësishëm, interesant, relevant dhe realist.)

➤ *Sfondi teorik:*

(Përmbledhje e njohurive të sfondit teorik dhe kontekstit të (nën)fushës së kërkimit, duke përfshirë literaturën kryesore, autorët kyç, gjetjet kryesore të kërkimit.)

➤ *Formulimi i problemit dhe qëllimet e hulumtimit:*

(Përshkrim i qartë dhe konciz i çështjeve që duhet të trajtohen; cili është problemi specifik në këtë hulumtim në këtë fushë studimi, përse po ndërmerret ky studim.)

➤ *Pyetjet dhe hipotezat e hulumtimit:*

(Formulimi i problemit në pyetje dhe hipoteza me qëllim hulumtimin e tyre përmes metodologjisë së përshtatshme për kërkimin në fjalë.)

➤ *Metodat dhe teknikat e hulumtimit:*

(Metodologjia e kërkimit përcakton metodat e kërkimit dhe hapat logjike : Çfarë duhet bërë, si të zgjidhet problemi dhe si arrihen objektivat e propozuar? Cilat metoda kërkimore do të përdoret?)

➤ *Rezultatet e hulumtimit:*

(Përmbledhje e rezultateve të pritshme.)

➤ *Literatura:*

(Listë paraprake e literaturës së parashqyrtuar dhe në dispozicion të studimit.)

Plani i punës:

<i>Periudha kohore</i>	<i>Aktivitetet që do të realizohen</i>
<i>Viti i parë</i>	
muaji, viti – muaji, viti	
<i>Viti i dytë</i>	





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE  
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA  
DEPARTAMENTI I GJUHË - LETËRSISË

<i>Viti i tretë</i>	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE DREJTËSISË**  
**DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA**  
**DEPARTAMENTI I GJUHËS DHE LETËRSISË**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
REKTORI

Vlorë më, 27.1.2025

Lënda : Ngarkohen për zbatimin e shkresës bashkëlidhur në respektim të legjislacionit përkatës në fuqi :

**Drejtuar:**

- **Senati**
- **Rektorati**
- **Bordi Administrimit**
- **Njësia e Auditit të Brendshëm**
- **Këshilli i Etikës**
- **Rektori**
  - **Qendra Studimore e Zhvillimit Rajonal**
  - **Spektori Juridik**
  - **Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore** ✓
    - Spektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës
    - Spektori i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun
    - Spektori i IT-së ✓
  - **Zv. Rektor për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin Insitucional**
    - **Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Projekteve**
    - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Insitucional
    - Spektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë
    - **Spektori i Kërkimit Shkencor dhe Promovimit Akademik**
  - **Zv. Rektor Akademik** ✓
    - **Drejtoria e Edukimit për Ciklin e Parë dhe të Dytë**
    - Spektori i Kurikulave dhe Shërbimit ndaj Studentëve
    - Spektori i Këshillimit të Karrierës Alumni dhe Aktiviteteve Kulturore Sportive
    - **Spektori i Bibliotekes Shkencore**

REKTORI  
Prof. Dr. Aurela SALIAJ

